

## Çmimi i blerjes se energjise elektrike ne tregun e liberalizuar

Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike për klientët që nuk furnizohen nga shërbimi universal përcaktohet në marreveshje mes klientit dhe furnizuesit të zgjedhur prej tij. Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare, apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditur Klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike. Ndryshimet e çmimit të energjisë elektrike bëhen me marreveshje të përbashkët. Furnizuesi në çdo rast njofton klientin me shkrim, për ndryshimin e çmimit jo më vonë se 15 ditë kalendarike përpara aplikimit të çmimit të ri. Njoftimi duhet ti referohet specifikisht ndryshimit të çmimit dhe jo informacioneve të tjera që lidhen me shërbimin e furnizim

“Tarifat dhe çmimet” janë pagesat që duhet të kryhen nga Klientët për shërbimet e energjisë elektrike, që sigurohen nga shoqëritë e licencuara nga ERE që ushtrojnë veprimtari të rregulluar në sektorin e energjisë elektrike. Tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike mund të rishikohen nga ERE me propozim të të licencuarve ose me iniciativën e vetë ERE-s, sipas parimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.